

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
1	09.01.2024	Kërkesë për dhënie mandati lidhur me zgjedhjet për kryetar fshati.	15.01.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut “ neni 16 pika 2 gërma b, është shprehur për ligjshmërinë e vendimit nr. 79 datë 27.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Lezhë për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave duke e konfirmuar atë.	E plotë	Pa tarife
2	10.01.2024	Kërkesë për vlerësim dëmtimi banese të shkaktuar nga tërmeti i vitit 2019.	12.01.2024	Prefekti I Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut “ ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjesjen Vendore” ligjin nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, këtë ankesë e ka përcjellë për trajtim njësisë vendore ku ai është banor, si organi kompetent për trajtimin e çështjeve të emergjencave civile duke vënë në dijeni dhe ankuesin.	E deleguar	Pa tarife
3	12.01.2024	Kërkesë për zhbllokimin e rrugës lidhëse nga banesa tek rruga nacionale.	16.01.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut “ ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjesjen Vendore, kjo ankesë i është përcjell për trajtim njësisë vendore ku ai është banor, si organi kompetent për trajtimin e çështjeve të infrastrukturës publike duke vënë në dijeni dhe ankuesin	E deleguar	Pa tarife

<sup>1</sup>Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

<sup>2</sup>Data e regjistrimit të kërkesës

<sup>3</sup>Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

<sup>4</sup>Data e kthimit të përgjigjes

<sup>5</sup>Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

<sup>6</sup>Përgjigja jepet E plotë / E kufizuar /E refuzuar / E deleguar

<sup>7</sup>Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE SHKURT 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
4	29.01.2024	Kërkesë për zgjidhje problemi për mungesë me furnizimin me energji elektrike dhe mungesën e transportit, pasi i janë drejtuar me ankesë Njesisë Administrative ku banon. Banori thekson se pergjigja e marrë nga Njësia Administrative nuk qëndron.	02.02.2024	Institucioni i Prefektit referuar ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut” pasi shqyrtoi kërkesën, thekson se nuk është në fushën e përgjegjësisë së Prefektit verifikimi i të dhënave të lëshuara me përgjigjshmëri të plotë nga ana e organeve të vetëqeverisjes vendore. Lidhur me furnizimin me energji elektrike ti drejtohet Organit përgjegjës OSHEE Group SH.A Tirane, pasi sipas të dhënave që disponojm si institucion rezulton se ofrohet furnizim me energji elektrike në çdo shtëpi, përveç rasteve kur janë debitor.	E plotë	Pa tarife
5	29.01.2024	Kërkesë nga banorë të Njesisë Administrative për asfaltimin e rrugës së amortizuar.	02.02.2024	Bazuar në nenin 15, pika 2 të ligjit nr.107/2016, “Për Prefektin e Qarkut ” dhe në nenin 23, pika 4 e ligjit nr. 139/2015,“Për Vetëqeverisjen Vendore” duke qenë se këta banorë i përkasin juridiksionit të bashkisë Kurbin dhe problematikat e infrastrukturës publike janë në fushën e përgjegjësisë të bashkisë Kurbin, është deleguar që të trajtohet kjo kërkesë, dhe për masat e marra të informohet Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë, dhe janë njoftuar banorët për delegimin e ankesës.	E deleguar	Pa tarife
6	31.01.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion kontrate shitblerje trualli për arsye procesi gjyqësor drejtuar Prefektit të Qarkut Lezhë	02.02.2024	Ankuesi është informuar se në Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë nuk ekziston si strukturë apo institucion në varësi Dega e shoqërive Publike Lezhë.	E refuzuar	Pa tarife

		dhe Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike				
7	08.02.2024	Kërkesë nga banorë për rishikimin e projektit të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.	13.02.2024	Ankesa e banorëve është deleguar për trajtim ligjor Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, si dhe janë njoftuar banorët për delegimin e ankesës.	E deleguar	Pa tarife
8	15.02.2024	Kërkesë për informacion dhe kopjeve të akteve nga Avokat i përfaqësuar me prokurë në lidhje me procedurën e ndjekur nga institucionet përkatëse në lidhje me projektin e ndertimit të HEC Kalivare.	16.02.2024	Kërkesa është dërguar për trajtim Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm-Erzen-Mat, dhe është vënë në dijeni ankuesi.	E deleguar	Pa tarife
9	15.02.2024	Kthim përgjigje nga ASHK Lezhë për kërkesën e drejtuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë me shkresën nr. 994/1 dt 12.12.2023 i është drejtuar Drejtorisë Vendore të ASHK-së Lezhë si organ kompetent për trajtim ligjor.	16.02.2024	ASHK Lezhë ka kthyer përgjigje se nuk mund të lëshojë certifikatë legalizimi me arsyen se ka diferencë në m2 sheshi i ndërtimit të lëshuar në lejen e ndërtimit nga bashkia Lezhë me certifikatën e përdorimit.	E plote	Pa tarife

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE MARS 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
-------------------------	------------------------------	---------------------------------	--------------------------------	------------------------	---	---------------------

10	04.03.2024	Kërkesë për ndryshim emri të fëmijës.	05.03.2024	Prefekti I Qarkut Lezhë me shkresen nr. 209/1 dt 5.3.2024 Kthim përgjigje referuar nenit 57 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009”Për gjendjen civile” të ndryshuar, kërkesa për ndryshim emri duhet të paraqitet pranë zyrës së Gjendjes Civile Laç, bashkia Kurbin. Dhe referuar ligjit të sipërcituar, ndryshimi i emrit dhe mbiemrit bëhet vetëm për rastet e papërshtatshmërisë. Institucioni përgjegjës që përcakton emrat e papërshtatshem, në kuptim e këtij ligji është Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile.	E plotë	Pa tarife
11	11.3.2024	Kërkesë për dëmshpërblim si pasoje e dëmtimit të tokës bujqësore si pasojë e mospastrimit të kanalit vaditës pas ankesës së bërë, dhe mosveprimit nga ana e bashkisë Mirditë.	11.3.2024	Prefekti I Qarkut Lezhë me shkresen nr. 243/1 dt 11.03.2024 Kthim përgjigje bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut “, në ligjin nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” është deleguar tek bashkia Mirditë që të trajtohet kjo kërkesë, dhe për masat e marra të informohet Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë, është njoftuar ankuesi për delegimin e ankesës.	E deleguar	Pa tarife

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
12	27.03.2024	Kërkesë nga banorë të fshatit Prull, Njësia Administrative Zejmen, Bashkia Lezhë. Me subjekt “Kundërshtimin e	03.04.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar Bashkisë Lezhë si organi kompetent për trajtimin e rastit dhe të informohet Institucioni i Prefektit brenda afateve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 44/2015 “Kodi I	E deleguar	Pa tarife

		projektit për instalimin e turbinave me erë në fshatin Prull”.		Procedurave Administrative I Republikës së Shqipërisë “. Është vënë në dijeni me shkresë dhe pala këkuese.		
13	15.04.2024	Kërkesë me lëndë “Ndërhyrje e Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë tek Gjykata Administrative e Apelit Tiranë për përsheptim të procedurës gjygjësore”.	17.04.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë bën me dije se, referuar pikës 3 të nenit 460 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi I Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë “se përsheptimi i proçeseve gjygjësore në Gjykatën e Apelit parashikohet shprehimisht:-palët mund ti kërkojnë me shkrim relatorit për shpejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 20/2020, Prefekti i Qarkut Lezhë, në zbatim të nenit 68, nuk është më palë paditëse apo e paditur në të gjitha proçeset gjygjësore që kanë për objekt deklaram pavlefshmërie të AMTP-vë.	E Plotë	Pa tarife
14	12.04.2024	Ankesë nga banorë të Bashkisë Kurbin për moszbatimin e punimeve sipas projektit “Asfaltim i rrugës Likaj-Demokracia”, financuar nga Bashkia kurbin. Banorët ankohen për gjerësinë e trasesë së rrugës dhe të trotuareve si dhe mungesën e kanalizimeve.	15.04.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar Bashkisë Kurbin si organi kompetent për trajtimin e rastit dhe të informohet Institucioni i Prefektit brenda afateve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 44/2015 “Kodi I Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë “. Është vënë në dijeni me shkresë dhe pala ankuese.	E deleguar	Pa tarife
15	22.04.2024	Këkesë nga banor i Bashkisë Mirditë për ndërhyrje të Prefektit të Qarkut Lezhë tek Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, për rishikimin e përfitimit të	23.04.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut “i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Lezhë si organi kompetent për trajtimin e rastit dhe të informohet Institucioni i Prefektit brenda afateve ligjore . Është vënë në	E deleguar	Pa tarife

		pensionit në bazë të bordorove sepse mendon se duhet të paguhet në vlerë më të lartë.		dijeni me shkresë dhe pala kërkuese.		
--	--	---	--	--------------------------------------	--	--

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE MAJ 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
16	02.05.2024	Kthim përgjigje nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale Lezhë prane Prefektit të Qarkut Lezhë lidhur me kërkesën me nr 334/1 Prot date 24.04.2024 për rishikimin e përfitimit të pensionit në bazë të bordorove, ku rezulton se nga analizimi i dokumentacionit së vjetërsisë në punë sipas ligjit 7703 datë 11.05.1193 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (I ndryshuar) sqarojnë se pensioni është llogaritur saktë sipas ligjit në fuqi. Ankuesi ka ma marrë përgjigje të vazhdueshme nga DRSSH Lezhë,	03.05.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar kërkuesit me datë 03.05.2024 ku informohet se nga korrespondenca me DRSSH Lezhë, si institucion përgjegjës për trajtimin e një kërkesë të tillë në bazë të ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar, rezulton se për këtë problematikë ka marrë përgjigje të vazhdueshme nga DRSSH Lezhë dhe online në portalin e-Albania. Sqarohet se Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë nuk ka kompetencë të ndërhyjë më tepër për dhënie zgjidhje të pretendimeve të kërkuesit. Për këtë çështje kërkuesi mund ti drejtohet Gjykatës kompetente, i është vënë në dispozicion dhe kopje e shkresës së DRSSH Lezhë.	E Plotë	Pa tarife

		ka marrë përgjigje online në portalin e-Albania. Pensioni është çertifikuar nga Auditi i ISSH.				
17	02.05.2024	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Njesisë Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, për ndërhyrje në problemin me furnizimin me ujë të pijshëm.	07.05.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut “i është drejtuar Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë si organi kompetent për trajtimin e rastit dhe të informohet Institucioni i Prefektit brenda afateve ligjore . Është vënë në dijeni me shkresë dhe pala kërkuese.	E deleguar	Pa tarife
18	07.05.2024	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Njesisë Administrative Selitë të Bashkisë Mirditë për verifikim banese të dëmtuar nga tërmeti i vitit 2019.	9.05.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut “, në ligjin nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në ligjin nr.45/2019,”Për Mbrojtjen Civile”, VKM-së nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave , të kategorive priotitare,masës së përfitimit, auoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, kërkohet që të verifikohet dhe trajtohet kërkesa e banorit të dëmtuar, dhe për veprimet dhe masat e marra të informohet Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë brenda afateve ligjore. Është vënë në dijeni me shkresë dhe pala Kërkuese.	E deleguar	Pa tarife

19	08.05.2024	Ankesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banorë të fshatit Zall-Xhuxhë, Njësia Administrative Fan, Bashkisë Mirditë në lidhje me zgjedhjet e bëra për kryesinë dhe kryetarin e fshatit Zall Xhuxhë.	23.04.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i është drejtuar Këshillit të Bashkisë Mirditë dhe Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për trajtim ligjor dhe marrjen në konsideratë nëse pretendimet e banorëve qëndrojnë, ankesat e banorëve të fshatit Zall Xhuxhë, pasi referuar nenit 70 pika 5 të ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeversisjen Vendore”:- Procesi I zgjedhjes dhe veprimtaria e kryesisë së fshatit mbikqyren nga kësilli bashkiak përkatës. Me marrjen e një vendimi, të informohet Institucioni i Prefektit brenda afateve ligjore. Është vënë në dijeni me shkresë dhe pala ankuese.	E deleguar	Pa tarife
20	14.05.2024	Ankesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i fshatit Zojs, Njësia Administrative Dajç, Bashkisë Lezhë në lidhje me mungesën e përgjigjes pas afatit kohor të 1(një) viti dhe mos rregjistrimin e tokës nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Lezhë.	16.05.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë Bazuar në nenin 5 të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”:- Agjensia Shtetërore e Kadastres është autoriteti publik përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Për sa më sipër i është drejtuar Drejtorisë Vendore të ASHK-së Lezhë për trajtim ligjor të kërkesë dhe të informohet Institucioni i Prefektit brenda afateve ligjore. Është vënë në dijeni me shkresë dhe pala ankuese.	E deleguar	Pa tarife
21	24.05.2024	Kërkesë – Ankesë nga banorë të Njesisë Administrative Fan, Bashkia Mirditë për zbatimin e masave ligjore, pezullimin e lejes	28.05.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë për trajtimin e kërkesë-ankesës i është drejtuar Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm-Erzen-Mat, bazuar në ligjin nr.111/2012 “ Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i	E deleguar	Pa tarife

		të shfrytëzimit të burimeve ujore për Hecin Thirrë.		ndryshuar, neni 13, VKM nr.221, datë 26.04.2018 “Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, Kapitulli III, pika 5, germa”a”(iv), kërkohet trajtimi i kësaj problematike dhe ndjekjen e procedurave gjyqësore për çështjen e cituar. Lidhur me trajtimin e këtij problemi të vihet në dijeni dhe Institucioni i Prefektit. Është vënë në dijeni me shkresë dhe pala ankuese.		
22	27.05.2024	Ankesë për ngritjen e çmimit të pagesës për m3 (meter kub) të ujit të pijshëm në Njësinë Administrative Orosh, Bashkia Mirditë.	28.05.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë për trajtimin e ankesës së banorëve të Njësisë Administrative Orosh, Bashkia Mirditë i është drejtuar Bashkisë Mirditë dhe Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime Lezhë për trajtim ligjor, referuar nenit 23 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” dhe referuar VKM-në nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. Për konkluzionet e marra nga institucionet e mësipërme të informohet zyrtarisht Institucioni i Prefektit, është vënë në dijeni me shkresë dhe pala ankuese.	E deleguar	Pa tarife

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE QESHOR 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
-------------------------	------------------------------	---------------------------------	--------------------------------	------------------------	---	---------------------

23	03.06.2024	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Njësisë Administrative Rubik, Bashkia Mirditë për largim nga puna pa të drejtë nga kompani private.	07.06.2024	Kthim përgjigje me shkresë ankuesit. Prefekti i Qarkut Lezhë e ushtron veprimtarinë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut, të ndryshuar”. Referuar Kërkesës nga ana e banorit nuk citohet të jetë krijuar një marrëdhënie pune kontraktuale mes dy palëve. Sa më sipër këshillohet që për çdo rast punësimi të kërkoni kontratën e punës ku të jenë të përcaktuara qartë kushtet e nenit 21 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.	E Plotë	Pa tarife
24	05.06.2024	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Bashkisë Lezhë, për mosveprim në rregjistrimin e lejes së legalizimit nga ana e Drejtorisë Vendore të Kadastrës Lezhë.	07.06.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në nenin 16 e vijues të ligjit nr. 20/2020 “Për Përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në republikën e Shqipërisë “i është drejtuar Drejtorisë Vendore të ASHK-së Lezhë për trajtim ligjorë të kërkesës së banorit dhe të informohet Institucioni i Prefektit mbi ecurinë e zgjidhjes së problematikës. Është vënë në dijeni me shkresë dhe pala kërkuese.	E deleguar	Pa tarife
25	11.06.2024	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Bashkisë Mirditë për anulim vendimi datë 10.05.2024 të këshillit të bashkisë Mirditë.	12.06.2024	Kthim përgjigje me shkresë ankuesit. Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut, i ndryshuar“, institucioni i Prefektit të Qarkut nuk ka kompetencë të anulojë aktet e nxjerra nga organet e vetëqeverisjes vendore. Në bazë të nenit 8 të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut, i ndryshuar“, në ushtrim të funksionit të tij, prefekti i qarkut ka këto përgjegjësi kryesore: a) verifikim e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore. Sa më sipër mbështetur në nenin 113, të Kodit të	E Plotë	Pa tarife

				procedurave Administrative, organi kompetent për anulimin e një akti administrativ është organi që e ka nxjerrë aktin ose gjykata administrative kompetente.		
26	13.02.2024	Ankesa e banorëve është deleguar për trajtim ligjor Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, si dhe janë njoftuar banorët për delegimin e ankesës.	21.02.2024	Kthim përgjigje Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, me shkresën datë 09.06.2023 DUK Lezhë në bashkëpunim me MBZHR-në ka shprehur gatishmërinë për zgjidhjen e problemit të gërryerjeve në fshatin Ferr-Shkopet duke hartuar projekt-preventivin i cili është dërguar në listen e prioriteteve të investimeve për vitin 2024. Projekti “Mbrojtja nga Gërryerjet e Lumit Mat në Skuraj (Ferr-Shkopet)” në këtë fazë me gjatësi 431 ml e cila është e domosdoshme për mbrojtjen e zones më të rrezikuar, përfshin: punime për argjinaturën provizore, punime për mbrojtjen gjatësore dhe punime për mbrojtjen tërthore. DUK Lezhë në bashkëpunim me MBZHR-në do të planifikojnë studim-projektim për vitin 2024 edhe për segmente të tjera të cilat rrezikojnë gërryerjen e tokave bujqësore në këtë zone. Janë vënë në dijeni me shkresë dhe banorët e Ferr – Shkopet.	E plotë	Pa tarife
27	03.04.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar Bashkisë Lezhë si organi kompetent për trajtimin e rastit dhe të informohet Institucioni i Prefektit brenda afateve ligjore	15.04.2024	Kthim përgjigje Bashkia Lezhë. Kompania AYEN RENEW ABLE ENERGY ka dërguar një kërkesë pranë Bashkisë Lezhë ku ka shprehur interesin dhe ka studiuar sipërfaqen e tokës pyjore që kërkon të marrë me qera për ndërtimin e parkut eloik. Bashkia Lezhë, referuar kërkesës së kompanisë ka bërë	E plotë	Pa tarife

		të parashikuara në ligjin nr. 44/2015 “Kodi I Procedurave Administrative I Republikës së Shqipërisë “. Është vënë në dijeni me shkresë dhe pala kërkuese.		përlllogaritjet për sipërfaqet pyjore të nevojshme për ndërtimin e parkut, prona të cilat Bashkia i posedon në pronësi sipas VKM-së numër 433 datë 08.06.2016 e ndryshuar me VKM-në nr 684 datë 02.09.2020. Lidhur me këtë procedure deri tani është zhvilluar konsultimi me publikun për informimin rreth këtij projekti dhe çdo procedure që do të zhvillohet në vijim do të mbahet në zbatim të akteve ligjore në fuqi. Janë vënë në dijeni me shkresë dhe banorët e Njësisë Administrative Zejmen.		
28	16.05.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë Bazuar në nenin 5 të ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”:- Agjensia Shtetërore e Kadastrës është autoriteti publik përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Për sa më sipër i është drejtuar Drejtorisë Vendore të ASHK-së Lezhë për trajtim ligjor të kërkesë dhe të informohet Institucioni i Prefektit brenda afateve ligjore. Është vënë në dijeni me shkresë dhe pala ankuese	29.05.2024	Kthim përgjigje Drejtoria Vendore ASHK-së Lezhë në zbatim të pikës 10, të VKM-së me nr. 1174 datë, 24.12.2020, në kутpim të kësaj Banori i Njësisë Administrative Dajç për dokumentacionin e përcjellur nga Bashkia Lezhë për rregjistrimin e Aktit të Marrjes në Pronësi me nr. 4288 duhet të aplikojë dhe të paguajë shërbimet kadastrale në bazë të VKM-se me nr. 389 datë, 13.05.2020 “ Për miratimin e listës dhe të tarifave për shërbimet kadastrale. Është vënë në dijeni me shkresë dhe pala ankuese.	E plotë	Pa tarife

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
29	03.07.2024	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga avokat perfaqësues, për vënie në dispozicion kopje e njësuar e dokumentacionit që ndodhet në dosjen e Vendimit të Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të Prefektures Lezhë, për nevoja të hetimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë.	04.07.2024	Kthim përgjigje me shkresë kërkuesit nga Prefekti i Qarkut Lezhë se: Dosja e vendimit “Për pavlefshmëri e plotë ligjore të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi” ndodhet e sekuestruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë bazuar në procesverbalin “Për sekuestrimin e provave materiale”.	E Plotë	Pa tarife

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE GUSHT 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
-	-	-	-	-	-	-

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE SHTATOR 2024

Nr. Rendo <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
30	17.09.2024	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i bashkisë Kurbin për ngritje komisioni për verifikim dëmtimi banese nga tërmeti i datës 24.07.2024, pasi ankesa e banorit drejtuar bashkisë Kurbin nuk ka marr përgjigje.	27.09.2024	Kthim përgjigje me shkresë kërkesit nga Prefekti i Qarkut Lezhë se: kërkesa i është deleguar për trajtim bashkisë Kurbin si organi kompetent. Përgjigjia e marrë nga bashkia Kurbin pasi ka shqyrtuar kërkesën e institucionit të Prefektit i është dërguar me shkresë zyrtare dhe palës ankuese.	E Plotë	Pa tarife

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE TETOR 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
31	4.10.2024	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i bashkisë Lezhë për problematikën e bllokimit të kanalit kullues pranë aksit rrugor Lezhë – Shëngjin. Banori kërkon zhbllokimin e kanalit kullues nga organet kompetente pasi uji deporton në	7.10.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë referuar ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, VKM nr. 234, datë 17.04.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr.600, datë 13.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronarë të rrugëve” si dhe ankesës së qytetarëve për bllokimin e kanaleve në aksin rrugor Lezhë – Shëngjin dhe Lezhë -Hoteli i Gjuetisë kërkesa i është deleguar me shkrim	E Deleguar	Pa tarife

		ambjentet e pronës së tij.		për trajtim bashkisë Lezhë dhe Drejtorisë së Rajonit Verior të ARRSH Shkodër si organe kompetente për riparimin e problematikave të shfaqura nga banorët.		
32	7.10.2024	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Njësisë Administrative Fan, Bashkia Mirditë, për mungesë të energjisë elektrike nga muaji dhjetor i vitit 2022. Kërkohet ndërhyrja e Prefektit të Qarkut Lezhë tek Administratori i OSHEE Tiranë për zgjidhje të problematikës së banorëve.	25.10.2024	Pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë është protokolluar përgjigjia nga OSHEE Tiranë për mungesën e energjisë elektrike në Njësinë Administrative Fan, Bashkia Mirditë, ku vihemi në dijeni se është përfshirë në planin e investimeve për vitin 2025 rikonstruksioni i linjes elektrike me kabell ABC në Agjensinë Mirditë, i cili parashikohet të zbatohet në vijim. Me datë 29.10.2024 Prefekti i Qarkut Lezhë, ka vënë në dijeni me shkresë zyrtare palën ankuese për përgjigjen e marrë nga OSHEE Tiranë.	E Plotë	Pa tarife

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE NËNTOR 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
33	8.11.2024	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i bashkisë Lezhë për problematikën e mospajesjes me çertifikatë pronësie të banesës së ndërtuar para vitit 1991.	12.11.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë duke mos pasur asnjë referencë dokumentacioni që banori disponon për pronën, referuar VKM-së Nr. 435, datë 26.6.2024 “Për një shtesë në Vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore” pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore ku banoni është ngritur struktura e posaçme e koordinimit të procesit të legalizimeve. Banori orientohet të paraqitet pranë kësaj zyre për nisjen e procesit të legalizimit të banesës.	E Plotë	Pa tarife
34	18.11.2024	Kërkesë e përsëritur pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i bashkisë Lezhë për problematikën e mospajesjes me	19.11.2024	Kthim përgjigjeje me shkresë kërkuesit nga Prefekti i Qarkut Lezhë se: Për pikën e dytë të kërkesës ku kërkohet nga institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë hapjen dhe verifikimin e dosjes së pronësisë së banorit ankues, kërkimin e ekspertëve dhe ballafaqimin e vendimeve	E Plotë	Pa tarife

		çertifikatë pronësie të banesës së ndërtuar para vitit 1991.		që janë marrë, sqarohet se: Verifikimi i titujve të pronësisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 10/2019 ka përfunduar me datë 31.12.2019. Me hyrjen në fuqi të ligjit 20/2020 të gjitha dosjet e pronësisë të marra nga Komisioni Vendor i Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të qarkut i janë dorëzuar Drejtorisë Vendore të Kadastres Lezhë. Komisioni Vendor i Titujve të Pronësisë nuk ekziston si strukturë që prej datës 31.12.2019. Referuar nenit 5 të ligjit nr.20/2020 banori duhet ti drejtohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për të përfunduar procesin e kalimit të pronësisë nëse disponohet dokumentacion ligjor që provon se ka fituar të drejtën e pronësisë në një nga mënyrat e njohura me ligj.		
35	07.11.2024	Kërkesë me postë elektronike pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banore e Bashkisë Lezhë për problematikën e mospagimit të pensionit social të invaliditetit.	20.11.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë ka deleguar ankesën e banores me poste elektronike pranë Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror Lezhë dhe Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social pranë Bashkisë Lezhë, si organe përgjegjëse për trajtim dhe zgjidhje ligjore. Për konkluzionet e marra të vihet në dijeni dhe institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.	E Deleguar	Pa tarife

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE DHJETOR 2024

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
36	02.12.2024	Kërkesë për infomacion pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga anëtar i këshillit të bashkisë Lezhë, mbi masat e marra për zbatimin e Paketës së Sigurisë në Shkollë.	12.12.2024	Prefekti i Qarkut Lezhë ka kthyer përgjigje me shkresë anëtarit të këshillit të bashkisë Lezhë, mbi masat e marra për zbatimin e Paketës së Sigurisë në Shkollë. Duke e vënë në dijeni për ngritjen e task forces vendore për garantimin e sigurisë në shkollë, ku bëjnë pjesë disa institucione vendore dhe bashkëpunimin e mirë ndërmjet tyre për zbatimin e planit të masave të miratuara.	E Plotë	Pa tarife
37	13.12.2024	Ankesë pranë Institucionit	20.12.2024	Kthim përgjigje me shkresë kërkuesit nga Prefekti i Qarkut Lezhë se: Bazuar në ligjin	E Plotë	Pa tarife

		të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i bashkisë Kurbin për zgjedhjen e kryetarit të fshatit Shpërdhet në kundërshtim me ligjin.		nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar se Prefekti i Qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ dhe se vendimet për zgjedhjen e kryesisë dhe kryetarëve të fshatit janë me karakter individual dhe nuk përcillen për shqyrtim ligjshmërie te Prefekti i Qarkut. Referuar ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”: Proçesi i zgjedhjes dhe veprimtaria e kryesisë së fshatit mbikqyren nga këshilli bashkiak përkatës. Sa më sipër është këshilli i bashkisë Kurbin organi kompetent për mbikqyrjen e proçesit të zgjedhjeve për kryesi dhe kryetar fshati.		
--	--	---	--	--	--	--

<sup>1</sup>Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

<sup>2</sup>Data e regjistrimit të kërkesës

<sup>3</sup>Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

<sup>4</sup>Data e kthimit të përgjigjes

<sup>5</sup>Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

<sup>6</sup>Përgjigja jepet E plotë / E kufizuar /E refuzuar / E deleguar

<sup>7</sup>Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.